

**RREGULLORE MBI CAKTIMIN E KËRKESAVE DHE PROÇEDURAVE PËR
PËRCAKTIMIN E OPERATORIT TË EMËRUAR E TREGUT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE (NEMO) DHE ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E TIJ DHE OPERATORIT
TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Neni 1

Fusha e Veprimit

1. Kjo rregullore përcakton kushtet dhe procedurat për përcaktimin e [një] Operatoritë emëruar të Tregut të Energjise Elektrike (NEMO) nga ERE.
2. Ky vendim përcakton detyrat që një NEMO duhet të kryejë në lidhje me procesin e bashkimit të tregjeve.
3. Ky vendim përcakton detyrat që [OST e Palës Kontraktore] do të kryejnë në lidhje me procesin e bashkimit të tregut.

Neni 2

Përkufizime

Aplikues (Aplikuesit) i referohen ndërmarrjeve të cilat kanë paraqitur aplikimet për tu bërë Operatorë të emëruar (nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike.

Rregullorja e Alokimit të Kapaciteteve dhe Menaxhimit të Kongjestioneve (CACM Regulation) i referohet Rregullores së Komisionit të BE 2015/1222 datë 24 Korrik 2015 mbi krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve.

Të ardhurat e kongjestioneve nënkupton të ardhurat e marra si rezultat i alokimit të kapaciteteve;

Algoritmi i pajtueshmërisë së tregut të vazhdueshëm nënkupton algoritmin e përdorur për bashkimin e tregut brenda ditës, për pajtueshmërine e porosive dhe alokimin (ndarjen) në mënyrë të vazhdueshme të kapaciteteve ndër-kufitare;

Pala tjetër qëndrore (Central counter party) nënkupton ndërmarrjen ose ndërmarrjet që kanë për detyrë të nënshkruajnë një kontratë me pjesëmarrësit e tregut, me anë të rinovimit të kontratave që rezultojnë nga procesi i pajtueshmërisë dhe organizimin e transferimit të pozicioneve të rrjetit që rezultojnë nga alokimi i kapaciteteve me palët e tjera qëndrore (**central counter parties**) ose agjentët e transportit;

Afatet e tregut të Ditës në Avancë nënkupton afatin e tregut të energjisë elektrike deri në kohën e mbylljes së ofertave për tregun në avancë, kur për çdo njësi kohe të tregut (**for each market time unit**), produktet tregëtohen ditën para se të shpërndahen;

Bashkim i tregut të ditës në avancë nënkupton procesin e tenderimit në rastin kur porositë e mbledhura perputhen dhe kapaciteti ndër-zonal alokohet në të njëjtën kohë për zona të ndryshme ofertimi tek tregu i ditës në avancë;

Afati i tregut të energjisë elektrike nënkupton kohën e mbylljes së ofertave për tregun e ditës në avancë, në rastin kur për çdo njësi matëse të tregut, produktet tregëtohen një ditë para se të shpërndahen;

Koha e mbylljes së ofertave për tregun e ditës në avancë nënkupton kohën deri kur porositë pranohen në tregun e ditës në avancë;

Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë (ECRB) i referohet Bordit Rregullator të organizates ndërkombëtare e cila është formuar sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Tepricat ekonomike për tregun e vetëm të ditës në avancë ose bashkimin e tregut brenda ditës nënkupton shumën e (i) tepricave të furnizuesit për bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë ose bashkimin e tregut brenda ditës për një periudhë të caktuar, (ii) tepricat e konsumatorit për bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë ose bashkimin e tregut brenda ditës, (iii) të ardhurat e kongjestionëve dhe (iv) kostot dhe përfitimet e tjera që kanë lidhje në rastin kur kjo rrit eficiencën ekonomike për një periudhë të caktuar, teprica e furnizuesit dhe e konsumatorit janë diferenca midis porosive të pranuar dhe çmimit për njesinë e energjisë të shumezuar me volumin e energjisë për porositë;

Afati për tregun brenda ditës nënkupton afatin e tregut të energjisë elektrike pas kohës së hapjes ndër-kufitare të ofertave për tregun intraday (**pas te njejtes dite cross-zonal gate opening time**) dhe para kohës së mbylljes ndër-kufitare të ofertave për tregun i te njejtes dite (**perpara te njejtes dite cross-zonal gate closure time**), kur për çdo njësi kohe të tregut, produktet tregëtohen para shpërndarjes së produkteve të tregëtuar;

Bashkimi brenda ditës nënkupton procesin e vazhdueshëm në rastin kur porositë e mbledhura përputhen dhe kapaciteti ndër-zonal ndahet në të njëjtën kohë për zona të ndryshme ofertimi në tregun intraday;

Koha ndër kufitare për hapjen e ofertave për tregun e përditshëm nënkupton kohën kur kapaciteti ndër – zonal midis zonave të ofertimit çlirohet për një kohë të caktuar të tregut dhe një zonë të caktuar kufizuese për ofertimin;

Koha ndër-kufitare për mbylljen e ofertave të tregut i te njejtes dite nënkupton kohën kur alokimi ndërzonal i kapacitetit nuk pranohet (lejohej) më për një kohë të caktuar të tregut;

Funksioni i Operatorit për Bashkimin e Tregut (funksioni i MCO) i referohet marrjes së porosive të pajtueshmërisë nga tregjet e ditës në avancë dhe tregjet i te njejtes dite për zona të ndryshme ofertimi dhe në të njëjtën kohë ndarjen (alokimin) e kapacitetit ndër – zonal;

Pajtueshmëria nënkupton mënyrën e tregëtimit përmes të cilës porositë e shitjeve i caktohen porosive të blerjes për të siguruar maksimizimin e tepricës ekonomike për bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë ose bashkimin e tregut intraday;

Monopoli ligjor në vend i referohet dhe përcaktohet si e tillë kur legjislacioni në vend i Palës respektive Kontraktore cakton një ndërmarrje të vetme për sigurimin e shërbimeve të tregëtimit të ditës në avancë dhe/ose tregëtimit intraday;

Operatori i Emëruar (nominuar) i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) nënkupton një ndërmarrje ligjore e cila është caktuar nga [ERE] për të kryer detyrat që kanë lidhje me bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe të tregut i te njejtes dite sipas kesaj rregulloreje;

Llogaritja e kapacitetit bazuar tek Kapaciteti i Transmetimit të Rrjetit është kapaciteti i rrjetit të transmetimit e cila nënkupton metodën e llogaritjes së kapacitetit bazuar tek parimi i

vlerësimit dhe përcaktimit të parashikimeve (**ex ante**) të shkëmbimit maksimal të energjisë midis zonave të ofertimit;

Porosi nënkupton synimin për të blerë ose për të shitur energji ose kapacitetin e dërguar (shprehur) nga një pjesëmarrës tregu sipas kushteve të veçanta të ekzekutimit;

Algoritmi i çmimit të bashkimit nënkupton algoritmin e përdorur për bashkimin e tregut të ditës në avancë për përputhjen e porosive dhe alokimit të kapaciteteve ndër – kufitare;

Shlyerja (settlement) është plotësimi i një transaksioni ose një procesi të likuidimit të pjesëmarrësve detyrimet përmes transferimit të fondeve dhe/ose garancive;

Agjent tregëtimi nënkupton ndërmarjet që kanë për detyrë transferimin e pozicioneve të rrjetit midis palëve të ndryshme qëndrore (**different central counter parties**);

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) nënkupton një personi juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe, zhvillimin e sistemit të transmetimit në një zonë të caktuar dhe kur aplikohet ndërlidhjet e tij me sistemet e tjera ndërkufitare, në përputhje me Nenin 2.4 të Direktivës së Energjisë Elektrike 2009/72/EC¹ dhe Nenin [neni 3, pika 48, te Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike 43/2015, i ndryshuar].

Neni 3

Caktimi i NEMO ve dhe kundërshtimi i tyre

1. Aplikimi për caktimin e veprimtarisë së Operatorit të Emëruar (nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) duhet të dërgohet pranë [ERE] me shkrim përmes postës elektronike email ose adresës së mëposhtme të kontaktit: [personi i kontaktit adresa e email dhe adresa e postës]
2. Aplikuesi duhet të përdorë formatin e Shtojcës 1.a. për të treguar pajtueshmërinë me kriteret e përmendura në Nenin 4 të këtij Vendimi aplikuesi duhet të paraqesë dokumentat e përmendur në Shtojcën 2 të këtij Vendimi.
3. Pas marrjes së kërkesës për caktimin e Operatorit të Emëruar (nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) duhet të marrë vendimin për krijimin e një monopoli në vend për shërbimet e tregëtimit të ditës në avancë dhe atij te te njejtës ditës brenda [dy] muajve.
4. Përcaktimi i Operatorit të Emëruar (nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) mbetet i vlefshëm deri në përfshirjen e Rregullores së Alokimit të Kapaciteteve dhe Menaxhimit të Kongjestionëve në legjislacionin në vend, sipas të cilës përcaktimi i NEMO duhet të konfirmohet sipas rregullave të Rregullores së Alokimit të Kapaciteteve dhe Menaxhimit të Kongjestionëve (CACM Regulation).
5. Në rastin kur duhet të caktohen disa aplikues për një Operatori të Emëruar (nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), [ERE] do të përcaktojë aplikuesin i cili pajtohet me kriteret e përmendura në Nenin 4. Kur të vendoset për aplikimin, duhet të shmangët çdo diskriminim përmes aplikuesve.

¹ OJ L 211 datë 14.08.2009, fq 55 et seq përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Këshillit Ministerial të Komunitetit të Energjisë 2011/02/MC-EnC.

6. ERE duhet të kundërshtojë përcaktimin nëse Operatorit të Emëruar (nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike, përcaktuar sipas këtij vendimi nuk i përmbush kriteret e pajtueshmërisë sipas Nenit 4 dhe nuk është në gjendje të përmbushë perseri pajtueshmërinë brenda [gjashtë] muajve pasi është njoftuar për mospajtueshmërinë nga [ERE].

7. [ERE] do të publikojë përcaktimin dhe kundërshtimin e Operatorit të Emëruar (nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) në faqen zyrtare dhe duhet të njoftojë ECRB.

8. [ERE] do të fiksojë ose miratojë tarifën e Operatorit të Emëruar (nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për tregëtimin në tregun e ditës në avancë dhe tregun e te njëjtes dite, mjaftueshëm në avancë të hyrjes së tyre në fuqi dhe para fillimit të funksionimit si Operator i Emëruar (nominuar) i Tregut të Energjisë Elektrike, ose të specifikojë metodologjitë e përdorura për ti përlogaritur ato.

Neni 4

Kriteret për përcaktimin e Operatorit të Emëruar (nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike NEMO

1. Aplikuesi duhet të caktohet si Operatorit të Emëruar (nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) nëse ai përmbush kërkesat e mëposhtme:
 - (a) ka kontraktuar ose do të kontraktojë burimet e duhura për operimin e përbashkët, të koordinuar dhe të pajtueshëm të bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë dhe/ose të tregut të te njëjtes dite përfshirë burimet e nevojshme për të përmbushur funksionet e Operatorit të Emëruar (nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike, burimet financiare, teknologjinë e nevojshme të informacionit, infrastrukturën teknike dhe procedurat operacionale ose duhet të sigurojë prova që është në gjendje të vendosë në dispozicion këto burime brenda një periudhe të arsyeshme përgatitore para marrjes së detyrave sipas Nenit 5;
 - (b) duhet të jetë në gjendje të sigurojë pjesëmarrësve të tregut akses tek informacioni në lidhje me detyrat e Operatorit të Emëruar (nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) sipas Nenit 5;
 - (c) duhet të jetë me *kosto efiçiente* në lidhje me bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë dhe bashkimin e tregut të te njëjtes dite dhe duhet që tek llogaritë e brendshme të mbajë një llogari të ndarë për funksionimin e Operatorit të Bashkimit të Tregut dhe veprimtaritë e tjera për parandalimin e ndër-subvencioneve;
 - (d) duhet të ketë nivelin e duhur të ndarjes së aktivitetit nga pjesëmarrësit e tjerë të tregut;
 - (e) nuk përdor tarifën e përmendur në Nenin 3(8) për të financuar veprimtaritë e tregëtimit të ditës në avancë dhe atij të te njëjtes dite tek një Palë tjetër nga ajo që mbledh tarifën;
 - (f) duhet të jetë në gjendje të trajtojë të gjithë pjesëmarrësit e tregut në mënyrë jo diskriminuese;
 - (g) Duhet të ketë rregullime të përshtatshme mbikqyrjen e duhur të tregut;
 - (h) Duhet të ketë marrëveshje të duhura të transparencës dhe konfidencialitetit me pjesëmarrësit e tregut dhe [OST-të e Palëve Kontraktore];

- (i) Duhet të jetë në gjendje të ofrojë shërbimet e nevojshme të larjes dhe të shlyerjes së likuidimeve;
- (j) Duhet të jetë në gjendje të vendosë sistemet dhe rregullat e nevojshme të komunikimit për tu koordinuar me [OST-të e Palës Kontraktore].

Neni 5

Detyrat e NEMO

1. Operatorët e Emëruar (nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMOs) duhet të veprojnë si operatorë të tregut tek [Palët Kontraktore] ose tregje rajonale për të kryer në bashkëpunim me [OST e Palëve Kontraktore] bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe tregut te te njejtës dite. Detyra e [tyre/saj] duhet të përfshijë marrjen e porosive nga pjesëmarrësit e tregut, për të patur një përgjegjësi për përputhjen dhe ndarjen e porosive sipas rezultateve të bashkimit të tregut të ditës në avancë dhe atij te te njejtës dite, për të publikuar çmimet dhe shlyerjen e kontratave që rezultojnë nga tregëtimi sipas marrëveshjeve dhe rregulloreve me pjesëmarrësit.

Në lidhje me bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë dhe atij te te njejtës dite, NEMO do të jetë veçanërisht përgjegjës për detyrat e mëposhtme:

- (a) zbatimin e funksioneve të Operatorit për Bashkimin e Tregut (MCO) të përcaktuara në paragrafin 2 në koordinim me Operatorët e tjerë të Emëruar (nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO);
- (b) zbatimin e kërkesave për bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë dhe atij te te njejtës dite, kërkesat për funksionet e Operatorit për Bashkimin e Tregut (MCO) dhe algoritmit për çmime të perbashkëta, sipas nivelit të BE, në lidhje me të gjitha çështjet që kanë lidhje me funksionimin e tregut të energjisë elektrike në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni;
- (c) zbatimin e çmimeve maksimale dhe minimale sipas nivelit të BE në përputhje me çmimet maksimale dhe minimale të përcaktuara sipas nivelit të BE ose rajonit;
- (d) bërja në mënyrë anonime (**making anonymous**), që nënkupton nuk mund ti jepet vetëm një pjesëmarrësi të tregut, dhe ndarjen e informacionit për porosinë e marrë të shprehur në Euro, e nevojshme për të kryer funksionet Operatorit për Bashkimin e Tregut (MCO) të parashikuar në paragrafin 2 të këtij Neni;
- (e) vlerësimin e rezultateve të llogaritura sipas funksioneve të Operatorit për Bashkimin e Tregut (MCO) të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij Neni, ndarjen e porosive bazuar tek këto rezultate, duke i parë rezultatet si përfundimtare nëse ato konsiderohen të sakta dhe ia dërgojnë ato OST-ve, të cilët duhet t'i vërtetojnë ato në përputhje me limitet e alokimit dhe kapaciteti ndërkuftar të vlefshëm;
- (f) informim i pjesëmarrësve të tregut në lidhje me rezultatet e porosive të tyre pa vonesa të pajustificueshme;

- (g) të veprojë si palë tjetër qendrore për shlyerjen dhe zgjidhjen e shkëmbimit të energjisë e cila rezulton nga bashkimi i tregut të vetëm të ditës në avancë dhe atij te te njejetes dite sipas meodologjisë së hartuar nga palët e interesuara të BE;
- (h) të miratojë dhe të zbatojë së bashku me Operatorët e tjere të Emëruar (nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) dhe OST procedurat përkatëse rezerve (**back up**) për operimin e tregut kombëtar ose rajonal nëse rezultatet nuk vendosen në dispozicion nga Operatori në funksion për Bashkimin e Tregut (MCO) duke patur parasysh procedurat mbështetëse (**fallback procedures**) të dakordësuara nga OST. Këto procedura rezervë (**back up procedures**) në nivel kombëtar dhe rajonal duhet të lejojnë ndarjen e kapacitetit në rastin kur procedurat e bashkimit nuk janë në gjendje të japin rezultate;
- (i) të sigurojë parashikimin e kostove për bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe atij te te njejetes dite dhe informacioni për kostot për autoritetet rregullatore kompetente dhe OST-të, kur kostot e NEMO për krijimin, ndryshimin dhe funksionimin e bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë dhe tregut te te njejetes dite, do të mbulohen nga kontributi i OST-ve në fjalë;
- (j) të koordinohet me OST-të për të krijuar marrëveshje në lidhje me më shumë se një NEMO brenda një zone ofertimi dhe të kryejë bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë dhe /ose atij te te njejetes dite në përputhje me marrëveshjet e aprovuara. Këto marrëveshje do të jenë në përputhje me praktikat më të mira për marrëveshjet e shumta të NEMO.
- Këto marrëveshje do të përmbajnë propozime për llogaritjen dhe ndarjen (alokimin) e kapacitetit ndërkufitar dhe rregullimet e tjera të nevojshme për këto zona ofertimi në bashkëpunim me OST-të dhe NEMO-t e interesuara, si dhe për të siguruar që OST-të dhe NEMO-t ofrojnë të dhënat e nevojshme (të tilla si përmes përdorimit të pikës së vetme fundore (**single – end point**) për shkëmbimin e të dhënave) dhe mbulimi financiar për marrëveshje të tilla të cilat lejojnë marrjen parasysh të disa Operatorë të Emëruar (nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për një zonë të tenderimit. Këto marrëveshje do të lejojnë që OST-të dhe NEMO-t e tjera tu bashkohen këtyre marrëveshjeve në të ardhmen;
- (k) të kryerja rolit e një agjenti të transportit, nëse vendoset nga [ERE i Palës Kontraktore].

2. Operatorët e Emëruar (nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) duhet të kryejnë funksionet e Operatorit të Bashkimit të Tregut (MCO) së bashku me Operatorët e tjerë të Emëruar (nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO). Këto funksione duhet të përfshijnë:

- (a) të zbatojë algoritmet, sistemet dhe procedurat për bashkim e tregu të vetëm të ditës në avancë dhe/ose bashkimin e atij te te njejetes dite siç përcaktohet sipas nivelit të BE. Nëse bashkimi i tregut midis dy ose më shumë zonave të ofertimit nuk përfshin një Shtet Anëtar të BE në hapin e parë, duhet të dakordësojë një zgjidhje të përkohshme dhe të zbatohet, në varësi të miratimit të ERE dhe në bashkëpunim të ngushtë me OST dhe NEMO e tjera të përfshira, kjo të krijon idenë se algoritmet, sistemet dhe procedurat për bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe / ose bashkimit të atij brenda ditës që zbatohen në BE deri sa të jetë e mundur, ndërkohë që lejon veçoritë e dy zonave të ofertimit;

- (b) përpunimi i të dhënave hyrëse mbi kapacitetin ndërkuftar dhe kufizimi i alokimit të parashikuara në procesin e llogaritjes së koordinuar të kapacitetit nga OST ose llogaritësi i koordinuar i kapacitetit që vepron në emër të OST. Këto të dhëna duhet t'i dorëzohen NEMO-ve përkatëse jo më vonë se një orë para kohës së mbylljes së tregut të ditës më përpara dhe jo më vonë se 15 minuta para kohës ndërkuftare të hapjes së portës të tregut të te njejtës dite;
- (c) duke vendosur në funksion çmimet e përbashkëta dhe algoritmet e përputhjes së vazhdueshme të tregëtimit sipas nivelit të BE. Nëse bashkimi i tregut midis dy ose më shumë zonave të ofertimit nuk përfshin një Shtet Anëtar të BE hapi i parë, është dakordësia e një zgjidhje e përkohshme dhe të zbatohet në varësi të miratimit të ERE] dhe në bashkëpunim të ngushtë me OST dhe NEMO e tjerë të përfshirë, që krijon idene se algoritmet që zbatohen në BE për sa kohë që është e mundur, ndërkohë që lejojnë veçoritë e dy zonave të ofertimit;
- (d) Verifikimi dhe dërgimin i rezultateve të bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë dhe tregut te te njejtës dite tek NEMO dhe OST.

3. Bashkëpunimi midis NEMO do të kufizohet vetem tek ajo që është e nevojshme për hartimin, zbatimin dhe funksionimin efikas dhe të sigurt të bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë dhe atij te te njejtës dite. Performanca e përbashkët e funksioneve të Operatorit të Bashkimit të Tregut (MCO) bazohet në parimin e mos diskriminimit dhe siguron që asnjë NEMO nuk mund të përfitojë nga avantazhet e pajustificuara ekonomike përmes pjesëmarrjes tek funksionet e MCO. Kjo kryesisht do të reflektojë dhe ndalojë përdorimin e informacionit të zoteruesit që nuk është në dispozicion të publikut nga NEMO për ti dhënë asaj avantazh të padrejtë ndaj konkurrentëve ekzistues ose të mundshëm ose përdoret për të maksimizuar fitimin ekonomik.

Neni 6

Detyrat e OST në lidhje me bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe atij te te njejtës dite

1. Pasi është caktuar Operatori i Emëruar (nominuar) i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) tek [Pala Kontraktore] sipas këtij Vendimi, [OST] duhet të marrë pjesë në bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe atij te te njejtës dite. OST do të koordinojnë me NEMO për të siguruar zbatimin eficient të bashkimit të tregut
2. [OST] do të:
 - (a) do të punojë me OST-të e Palëve Kontraktore të Komunitetit të Energjisë dhe/ose Shtetet Anëtare të BE për të siguruar funksionimin e një çmimi të përbashkët dhe algoritmave të vazhdueshëm për përputhjen e tregëtimit për të gjitha aspektet që kanë lidhje me ndarjen (alokimin) e kapacitetit përcaktuar sipas nivelit të BE;
 - (b) do të kontribuojë për miratimin e përbashkët të përputhjes (pajtuueshmërisë) së algoritmeve ndaj kërkesave përcaktuar sipas nivelit të BE;
 - (c) në bashkëpunim me OST e tjera do të kryejë kalimin (transferimin) e kapacitetit neto (**net transfer capacity NTC**) sipas llogaritjes së kapacitetit tek D-2 për të mbështetur bashkimin e tregut;

- (d) të llogarisë, në bashkëpunim me OST-të e tjera kapacitetet ndërkufitare dhe kufizimet e ndarjeve (alokimit) për NEMO përkatëse jo më vonë se 1 orë para mbylljes së ofertave për tregun e ditës në avancë. Nëse OST nuk është në gjendje ti ofrojë këto të dhëna ato duhet të njoftojnë NEMO-t respektive dhe duhet ti ofrojnë të dhënat jo më vonë se 30 minuta para mbylljes së ofertave për tregun e ditës në avancë;
- (e) të kontrollojë rezultatet e bashkimit të tregut të ditës në avancë në lidhje me kapacitetet ndërkufitare dhe kufizimeve të ndarjes (alokimit) të miratuara;
- (f) të respektojë rezultatet e bashkimit të tregut të ditës në avancë dhe bashkimit të tregut të te njejtës dite të llogaritura sipas gërmes (e) të këtij Neni;
- (g) të krijojë dhe vendosë në funksion procedurat mbështetëse (**fallback procedures**) sipas rastit për alokimin e kapacitetit;
- (h) Të dakordësojë me OST e tjera dhe të propozojë kohën e hapjes ndër-kufitare të ofertave për tregun e te njejtës dite dhe kohën e mbylljes ndër-kufitare të ofertave për tregun e te njejtës dite sipas proceseve të BE;
- (i) Të ndajë të ardhurat e kongestionit sipas metodologjisë së miratuar me OST respektive sipas metodologjive të BE;
- (j) Në rastin kur është rënë dakord, të veprojë si agjent transporti për transferimin e pozicioneve në rrjet.
- (k) të luajë rolin e agjentit të transportit nëse është vendosur nga [ERE

Shtojca 1.a

Modeli i formularit të aplikimit

1. Informacion mbi ndërmarrjen ligjore:

- a) **Emri i aplikimit:** [vendosni emrin e ndërmarrjes]
- b) **Adresa e aplikuesit:** [vendosni adresën në të cilën është regjistruar aplikimi]

2. Informacioni i kontaktit për aplikim

- a) **Emri i personit të kontaktit** [vendosni emrin e personit të kontaktit]
- b) **Pozicioni i personit të kontaktit** [vendosni pozicionin e mbajtur të personit të kontaktit në tek aplikuesi]
- c) **Numri i telefonit të personit të kontaktit:** [vendosni numrin e telefonit të personit të kontaktit]
- d) **Adresa e email-it e personit të kontaktit:** [vendosni adresën e email-it të personit të kontaktit]
- e) **Adresa postare e personit të kontaktit:** [vendosni adresën postare të personit të kontaktit]

3. Deklaratë nëse aplikuesi po aplikon për tu caktuar [emri i palës kontraktore] për bashkim e tregut të ditës në avancë dhe/ose atij brenda ditës:

[Ndërmarrja] po aplikon për tu caktuar nga [Pala Kontraktore] si Operator i Emëruar (Nominuar) i Tregut të Enegjisë Elektrike për të funksionuar [fshijeni nëse është e arsyeshme]: për bashkim e tregut të vetëm të ditës në avancë dhe atij te te njejtës dite;

Nëse ekziston më shumë se një zonë Ofertimi tregoni për cilën zonë ofertimi po bëhet aplikimi:

[Nëse zbatohet, vendosni se për cilën zonë ofertimi nevojitet ky aplikim]

4. A ka aplikuar ndërmarrja aplikuese për tu caktuar si Operator i Emëruar (Nominuar) i Tregut Enegjisë Elektrike (NEMO) tek një palë tjetër dhe nëse po tek cila palë/zonë ofertimi:

[Vendosni emrin e palës & zonën e ofertimit për të cilën ka aplikuar ndërmarrja]

A është refuzuar ndonjë aplikim, nëse po për cilën palë dhe për çfare arsye:

[Vendosni palën dhe arsyen]

5. Deklaratë nëse ndërmarrja është aktive si një monopol ligjor në një treg tjetër: [Fshijeni sipas rastit]

[Ndërmarrja] nuk është aktive si një monopol ligjor në një treg tjetër [Ndërmarrja] është aktive si një monopol ligjor tek [vendosni tregun].

6. Deklaratë nëse i gjithë ose një pjesë e aplikimit është konfidenciale, arsyet përse dhe cili paragraf:

- a) **A përmban aplikimi informacion konfidencial:**
- b) [Fshijeni sipas rastit] Po/Jo
- c) **A është i gjithë apo një pjesë e aplikimit konfidencial:**

[Fshijeni sipas rastit] Gjithë/ Një pjesë e aplikimit janë konfidenciale.

Nëse vetëm disa pjesë të aplikimit janë konfidenciale ju lutem nënvijëzojini ato në tekst.

d) Arsyetimi për konfidencialitetin:

[Vendosni arsyetimin për konfidencialitetin]

7. Nënshkrimi dhe deklarata për korrektësinë e informacionit të paraqitur:

Unë, [vendosni emrin], jam autorizuar të paraqes aplikimin për emërim si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) dhe garantoj që informacioni dhe dokumentat e paraqitura si pjesë e këtij aplikimi janë të vërteta, korrekte dhe përfshijnë të gjithë informacionin e nevojshëm të njohur nga [shoqeria] në mënyrë që ERE të vlerësojë aplikimin e [shoqeria].

[Firma, emri i nënshkruesit të autorizuar dhe pozicioni, vendi dhe data]

Lista e dokumentave të paraqitur si pjesë e këtij aplikimit:

[Lista e dokumentave]

Shtojca 1.b

Interpretim i Nenit 4 dhe dokumentave mbështetëse të cilat duhen të paraqiten në përputhje me të, duke marrë në konsideratë shembujt më të mirë nga Shtetet Anëtare të BE

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.1.a:

Ka kontraktuar ose do të kontraktoje burimet e duhura për funksionimin e perbashket, të koordinuar dhe të pajtueshem të bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë dhe/ose të njejtës dite, duke përfshirë burimet e nevojshme për të përmbushur funksionet e Operatorit të Emëruar (Nominuar) i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), burimet financiare, teknologjinë e nevojshme të informacionit, infrastrukturën teknike dhe procedurat funksionale ose duhet të vërtetojë që është në gjendje të vendosë këto burime në dispozicion brenda një periudhe përgatitore të arsyeshme përpara se të marrë detyrat e tij.

Interpretimi:

Aplikuesit duhet të përfshijnë informacion në lidhje me:

- Të ketë kapital të mjaftueshëm dhe siguri financiare për të mbuluar shpenzimet e aktiviteteve dhe ekspozimin ndaj riskut në mënyrë që të drejtojë bashkim eficient, të besueshëm dhe të qëndrueshëm të tregut të vetëm të ditës në avancë dhe/ose atij te te njejtës dite;
- Të ketë platformat e nevojshme të përdoruesit dhe zona të veprimit, që përfshijnë informacionin e nevojshëm teknologjik (software), pajisjet teknike (hardware dhe infrastrukturën), dhe/ose marrëveshjet kontraktore të nivelit të shërbimit për sigurimin e këtyre shërbimeve, së bashku me planet për rastet emergjente (**contingency**), për të siguruar bashkim eficient, të sigurt dhe të qëndrueshëm të tregut të ditës në avancë dhe/ose atij te te njejtës dite;
- Të ketë marrëveshjet funksionale të nevojshme dhe marrëveshjet kontraktore me Operatorët e Emëruar (Nominuar) të Energjisë Elektrike (NEMO), Operatorët e Shërbimit të Transmetimit (OST) dhe pjesëmarrësit e tjerë përkatës të tregut si edhe planet për rastet emergjente, që tregojnë mënyrën si një Operator i Emëruar (Nominuar) i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) do të përmbushë detyrimet e përcaktuara:
 - Ato duhet të përfshijnë detyrimin që aplikuesi ka nënshkruar ose do të nënshkruajë marrëveshjet e kërkuara funksionale ose kontraktore në rastin kur operon më shumë se një Operator i Emëruar (Nominuar) i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) tek një zonë ofertimi;
 - Gjithashtu duhet të përfshijë dëshmi që janë bërë parashikimet të cilat u mundësojnë Operatorëve të rinj të Sistemit të Transmetimit dhe Operatoreve të Emëruar (Nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) të nënshkruajnë të njëjtat marrëveshje.

Dokumentacioni i nevojshëm si provë:

Sipas rastit, aplikuesi pritet të paraqesë dokumentat mbështetës të mëposhtëm:

1. Çertifikatën e regjistrimit;

2. Prova se është kuptuar mjaftueshëm (ose është kontraktuar) legjislacioni përkatës;
3. Raporti vjetor i fundit që është audituar;
4. Plani financiar që planifikon të ardhurat e këtij viti dhe të vitit që vjen dhe konsiston në lidhje me detyrat e Operatorit të Emëruar (Nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) dhe përbehet nga:
 - a. Bilanci;
 - b. Deklarata e të ardhurave -humbjeve;
 - c. Analizim i kapitalit;
 - d. Deklarim i paster i supozimeve që janë baza e planifikimeve;
 - e. Një analizë studimore e parashikimit të ndryshimeve të dhëna sipas supozimeve;
 - f. Një analizim i qartë i mënyrës se si aplikuesi planifikon të financojë funksionimin duke përfshirë detajet e garancive që u janë dhënë aplikuesve me qëllim për tu përdorur.
5. Një Plan Biznesi i cili lidhet me detyrat e tij si Operator i Emëruar (Nominuar) i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) që përfshin:
 - a. Një analizim të detajuar operacional ku përfshihen proceset thelbësore;
 - b. Një përshkrim të qartë dhe shpjegim se si do të funksionojë bashkimi i tregut të vetem të ditës në avance dhe/ose atij të te njejtës dite duke përfshirë strukturën organizative;
 - c. Strukturën organizative përfshirë personelin e Burimeve Njerezore për funksionimin dhe në mënyrë të veçantë ato që kanë lidhje me ofrimin e shërbimit IT;
 - d. Kodin e sjelljes dhe programin e pajtueshmërisë;
 - e. Synimin, natyrën, dhe qëllimin e caktimit të detyrës që do të kryhen nga palët e treta dhe procedura të cilën aplikuesit synojnë të përdorin për të mundur shpërndarjen e palës së tretë;
 - f. Shpjegim i detajuar i sistemeve teknike dhe IT me qëllim për tu përdorur dhe besueshmërinë funksionale të sistemeve në fjalë;
 - g. Nëse aplikohet si mundet që aplikuesi të identifikojë dhe menaxhojë ose të shmangë konfliktet e interesit;
 - h. Shpjegim i detajuar i planit se si aplikuesi ka për qëllim të bashkëpunojë me Operatorët e tjerë të Emëruar (Nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) dhe Operatorët e Sistemit të Transmetimit (OST) dhe sigurimit që çdo marrëveshje do të vendoset jo më larg se 2 muaj pasi të jetë miratuar përcaktimi i Operatorit të Emëruar (nominuar) të Energjisë Elektrike (NEMO);
 - i. Shpjegim të detajuar në lidhje me procesin e identifikimit dhe menaxhimit të rreziqeve dhe planifikimi të përshtatshëm i rasteve emergjente.

Kriter i përcaktuar në Nenin 4.1.b:

Do të jetë në gjendje të sigurojë që pjesëmarrësit e tregut të kenë akses të hapur tek informacioni përsa i përket detyrave të Operatorit të Emëruar (Nominuar) të Energjisë Elektrike (NEMO) sipas Nenit 7

Interpretimi:

Aplikimet duhet të vërtetojnë dhe sigurojnë që do të jenë në gjendje të publikojnë informacionin dhe të dhënat në mënyrë të hapur (siç janë: marrëveshjet, metodologjitë, rregullat, procedurat dhe të dhënat) si kërkohen dhe që ky akses do të jetë në dispozicion njësoj për të gjithë pjesëmarrësit e tregut.

Dokumentacioni i nevojshëm si provë:

Sipas rastit, aplikuesi pritet të paraqesë dokumentat mbështetës të mëposhtëm:

1. Një strategji të qartë komunikimi që përfshin:
 - a. Përshkrim dhe dëshmi për vendin ku dhe mënyrën si pjesëmarrësit e tregut do të kenë mundësinë për të patur akses në informacion;
 - b. Proçesin e publikimit të të dhënave;
 - c. Përshkrim i planeve për rastet emergjente për tu siguruar që ky informacion është në dispozicion.

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.1.c:

Duhet të jetë me kosto eficient në lidhje me bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë dhe atij te te njejtes dite dhe duhet të mbajë llogari të veçanta për funksionet e Operatorit të Bashkimit të Tregut (MCO) dhe aktiviteteve të tjera në mënyrë që të parandalohet ndër-subvencionimin.

Interpretimi:

Aplikimet duhet të përfshijnë prova që ato kanë llogari të veçanta për funksionet e Operatorit të Bashkimit të Tregut (MCO) dhe aktivitetet e tjera të Operatorit të Emëruar (Nominuar) të Tregut të Energjisë Elektike (NEMO) dhe mund të bëjë një analizë të qartë të të gjitha shpenzimeve të Operatorit të Emëruar (Nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO). Kjo do të mundesoje që ERE të përcaktojë se në çfarë niveli ofrimi i shërbimeve është me kosto eficiente. Kjo mund të bëhet ose me anë të krahasimit me aplikime të tjera, nëse më shumë se një aplikim është paraqitur, ose nëpërmjet qasjes së Autoriteteve të tjera Rregullatore të cilat më herët janë caktuar si NEMO.

Dokumentacioni i nevojshëm si provë:

Sipas rastit, aplikuesi pritet të paraqesë dokumentat mbështetës të mëposhtëm:

1. Përshkrim të qartë dhe shpjegim të proçeseve të llogaritjes të cilat do ti japin mundësinë aplikuesit të identifikojë dhe ndajë kostot e Operatorit të Bashkimit të Tregut (MCO) dhe Operatorit të Emëruar (Nominuar) të Tregut të Energjisë Elektike (NEMO);
2. Përshkrim të qartë dhe shpjegim të llogarive të veçanta të cilat do të përdoren për kostot e Operatorit të Bashkimit të Tregut (MCO) dhe Operatorit të Emëruar (Nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO);
3. Përshkrim të qartë të proçeseve të raportimit të një analizimi të qartë të të gjitha kostove të Operatorit të Emëruar (Nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike, përfshirë shpenzimet e Operatorit të Bashkimit të Tregut (MCO);

4. Një krahasim të shpenzimeve të aplikuesit në lidhje me shembujt e Bashkimit European (BE) të ndara sipas kostove të Operatorit të Emëruar (Nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) dhe Operatorit të Bashkimit të Tregut (MCO).

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.1.d:

ai do të ketë një nivel të përshtatshëm të ndarjes së biznesit nga pjesëmarrësit e tjerë të tregut.

Interpretimi:

Aplikimet duhet të përfshijnë prova të një ndarjeje të mjaftueshme të biznesit në masën që çdo biznes i lidhur të mos ketë mundësinë të përdorë informacionin e Operatorit të Emëruar (Nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) dhe Operatorit të Bashkimit të Tregut (MCO) që nuk janë konfidenciale për publikun për avantazhin e tyre të padrejtë. Kjo nënkupton që aplikimi duhet të përfshijë, për transparencë, çdo konflikt interesi të mundshëm që mund të ngrihet nga pronësia apo lidhja me pjesëmarrës të tregut. Që do të thote, aplikuesi nuk duhet të jete në rastin kur mund të ndahet me ose pa qëllim për të favorizuar një pjesëmarrës të tregut i cili mund të jetë pronari ose të ketë lidhje me aplikuesin. Përveç kësaj, në rastet kur aplikuesi ka një konflikt interesi të mundshëm, aplikuesi duhet të paraqesë një procesin dhe mekanizmin për të siguruar një ndarje të mjaftueshme.

Dokumentacioni i nevojshëm si provë:

Sipas rastit, aplikuesi pritet të paraqesë dokumentat mbështetës të mëposhtëm:

1. Përshkrim të qartë dhe shpjegim të strukturës së aplikuesit duke përfshirë, por jo plotësisht, përbërjen e bordit të tij ose organet e tjera qeverisëse dhe drejtorët si dhe, nëse është e mundur, interesimin e tyre në treg pavarësisht lidhjes së tyre me aplikuesin;
2. Informacion në lidhje me një biznes tjetër të mundshëm të aplikuesit përveç shërbimeve të tregut të ditës në avancë dhe te te njejtës dite;
3. Deklaratë nëse aplikuesi është aktiv në palët e tjera dhe nëse po cfarë aktiviteteve po ndërmerr në këto palë;
4. Një përmbledhje e plotë e të gjitha insitucioneve në vartësi funksionale të pjesëmarrësve të tjerë të tregut;
5. Informacion në lidhje me përbërjen dhe identitetin e zotuesve të direkte dhe indirekte, palë të tjera të lidhura ligjore, kompanitë mëmë, dhe filialet e tyre;
6. Në rast se aksionerët, palët e tjera ligjore, kompanitë mëmë, ose filialet janë pjesëmarrës të tregut, duhet një shpjegim sesi aplikuesi ka organizuar ndarjen e biznesit.

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.1.e:

nëse është përcaktuar si një monopol ligjor kombëtar për shërbimet e tregëtimit të ditës në avancë dhe atyre te te njejtës dite tek një Palë Kontraktore, nuk do të përdorë tarifën e përcaktuar në Nenin 5(1) për të financuar aktivitetet e tregjeve të ditës në avancë dhe te te njejtës dite tek një Palë Kontraktore përveç atyre ku janë mbledhur këto tarifa

Interpretimi:

Aplikuesi duhet që, nëse është përcaktuar si një monopol në vend, të përfshijë dokumentacionin që vërteton se ka llogari të vecanta për shërbimet që mundëson si një monopol ligjor në vend

për shërbimet e tregjeve të ditës në avancë dhe ato të te njejtës dite nga ato shërbime nga cdo aktivitet tjetër.

Dokumentacioni i nevojshëm si provë:

Sipas rastit, aplikuesi pritet të paraqesë dokumentat mbështetës të mëposhtëm:

1. Një përshkrim dhe shpjegim të qartë të proceseve të tij të llogaritjes për çdonjërin prej aktiviteteve ligjore monopol.

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.1.f:

do të jetë në gjendje të trajtojë të gjithë pjesëmarrësit e tregut në mënyrë jo – diskriminuese

Interpretimi:

Aplikuesit duhet të paraqesin prova që ata mund dhe do të trajtojnë të gjithë pjesëmarrësit e tregut në të njëjtën formë dhe në mënyrë jo diskriminuese. Kjo duhet të përfshijë procedura të cilat mundesojnë që hyrjet e reja në treg të lejohen të futen me të njëjtat marrëveshje sikurse aplikohet për pjesëmarrësit ekzistues të tregut.

Dokumentacioni i nevojshëm si provë:

Sipas rastit, aplikuesi pritet të paraqesë dokumentat mbështetës të mëposhtëm:

1. Një shpjegim të detajuar të procedurave që pjesëmarrësit e tregut i bashkohen dhe do të përdorin shërbimet e aplikuesit të cilat nuk lejojnë diskriminimin;
2. Rregullat e tregut të cilat do të aplikohen për të gjithë pjesëmarrësit e tregut për të siguruar që nuk do të ketë diskriminim;
3. Procedurat e brendshme të cilat duhet të bëhen me shkrim siç janë marrëveshjet funksionale, marrëveshjet kontraktore, dhe shërbimet për pjesëmarrësit e tregut të mos jenë diskriminuese.

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.1.g:

do të ketë marrëveshje të përshtatshme të mbikqyrjes së tregut në vend

Interpretimi:

Aplikuesit duhet të vërtetojnë që ata kanë zbatuar ose do të zbatojnë një program trajnimi dhe procedura monitorimi të cilat do ti lejojnë aplikuesit të identifikojnë dhe raportojnë çdo çështje të mundshme në lidhje me përfshirjen e tregut të energjisë elektrike me shumicë dhe parimet e transparencës dhe ato jo diskriminuese.

Dokumentacioni i nevojshëm si provë:

Sipas rastit, aplikuesi pritet të paraqesë dokumentat mbështetës të mëposhtëm:

1. Interpretim i detajuar i programeve të trajnimit duke përfshirë:
 - a. Që drejtuesit dhe punonjësit kanë ose do të kenë njohje të marrëveshjeve të mbikqyrjes së tregut;
 - b. Që drejtuesit dhe punonjësit janë ose do të jenë në dijeni për çështjet e mbikqyrjes së tregut, psh. çështjet e Rregullores së Përfshirjes dhe Transparencës së Tregut të

Energjisë Elektrike me Shumicë (**REMIT Regulation on Wholesale Energy Market Integrity and Transparency**)

- c. Që drejtuesit dhe punonjësit janë në dijeni të përgjegjësive të tyre për të raportuar çdo çështje të mundshme të mbikqyrjes së tregut.
2. Interpretim të qartë dhe të detajuar si dhe shpjegim të skemave të monitorimit dhe proceseve të:
- a. grumbullimit të informacionit;
 - b. monitorimit të aktiviteteve të tregëtimit;
 - c. identifikimit të rasteve të mundshme;
 - d. vlerësimit dhe analizimit të rasteve të mundshme;
 - e. përshkallëzimit të çështjeve të brendshme të mundshme dhe në linjë me autoritetet përkatëse;
 - f. dhe kush nga ndërmarrja do të mbajë përgjegjësinë kryesore dhe nëse do të krijohet një njësi e re për këtë arsye.

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.1.h:

duhet të jenë marreveshjet e duhura për transparencën dhe konfidencialitetin me pjesëmarrësit e tregut dhe Operatorët e Sistemit të Transmetimit

Interpretimi:

Aplikuesit duhet të tregojnë që ata kanë ose do të zbatojnë ose ndryshe do të nënshkruajnë së bashku me pjesëmarrësit përkatës të tregut dhe Operatorët e Sistemit të Transmetimit marrëveshje të cilat do të përfshijnë transparencën dhe konfidencialitetin e të gjitha palëve të përfshira.

Dokumentacioni i nevojshëm si provë:

Sipas rastit, aplikuesi pritet të paraqesë dokumentat mbështetës të mëposhtëm:

1. Interpretim të detajuar të mënyrës se si aplikuesit do të vlerësojnë, miratojnë dhe zbatojnë marrëveshjet për transparencë dhe konfidencialitet me aksionerët aktuale dhe të ardhshëm të tregut dhe Operatorët e Sistemit të Transmetimit.
2. Të paraqesë çdo marrëveshje ekzistuese që aplikohen/zbatohen.

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.1.i:

Duhet të jetë në gjendje të ofroje shërbimet e shlyerjes

Interpretimi:

Aplikuesit duhet të vërtetojnë që ata janë ose kanë kontraktuar një ndërmarrje e cila është në gjendje të ofrojë:

- Të ketë kapital të mjaftueshëm dhe siguri financiare, së bashku me procedurat për të siguruar garanci të kënaqshme për shlyerjet, të nevojshme për të shlyer dhe likuiduar shkëmbimin e energjisë që rezulton nga bashkimi i tregut të vetëm të ditës në avancë dhe/ose tregut Te te njejtës dite

- Marrëveshjet teknike, operacionale dhe kontraktuale për të shlyer dhe likuiduar shkëmbimin e energjisë elektrike që rezulton nga tregu i vetëm i ditës në avancë dhe/ose tregu i përditshëm. Në mënyrë të veçantë kandidatet të cilët aplikojnë për bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë dhe/ose atij brenda ditës duhet të vërtetojnë që ata kanë ose do të hyjnë në marrëveshje operacionale/kontraktuale të cilat lejojnë më shumë se një Operator të Emëruar (nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) të operojë tregun e ditës në avancë dhe/ose tregun Te te njejtës dite

Dokumentacioni i nevojshëm si provë:

Sipas rastit, aplikuesi duhet të paraqesë dokumentat mbështetëse të mëposhtme:

1. Shpjegim i detajuar i kostove të operimit dhe kërkesave të kolateralit si dhe mbajtja e tyre;
2. Përshkrim dhe shpjegim i qartë i proceseve për të vendosur se cilat garanci nevojiten për shlyerje (likuidim);
3. Vlerësim i riskut dhe analizë studimore e bërë për të treguar përshtatjen në vazhdim;
4. Përshkrimi i qartë dhe shpjegimi i mënyrës se si aplikuesit duhet planifikojnë pagesën dhe shlyerjen, përfshirë:
 - a. Rregullat që aplikohen;
 - b. Kërkesat e anetareve,
 - c. Proceset për pagesën dhe shlyerjen, përfshirë atë me Operatorët e Emëruar (nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike dhe Operatorët e Sistemit të Transmetimit.
5. Përshkrimin e qartë dhe shpjegimin e marrëveshjeve kontraktuale të nevojshme për të shpërndarë proceset e shlyerjes dhe likuidimit, përfshirë NEMO dhe OST e tjera dhe konfirmimin për marrëveshjet e operimit dhe ato kontraktuale të cilat lejojnë ose do të lejojnë NEMO dhe OST e tjera që të funksionojnë bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe/ose atë te te njejtës dite.

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.1.j:

do të jetë në gjendje të vendosë sistemet e nevojshme të komunikimit dhe praktikat për kordinim me Operatorët e Sistemit të Transmetimit

Interpretimi:

Aplikuesit duhet të vërtetojnë që ata janë në gjendje të vendosin komunikimin e nevojshëm dhe sistemet teknike dhe marrëveshjet për tu kordinuar me Operatorët e Sistemit të Transmetimit.

Dokumentacioni i nevojshëm si provë:

Sipas rastit, aplikuesi duhet të paraqesë dokumentat mbështetëse të mëposhtme:

1. Përshkrim dhe shpjegim të mënyrës si do të komunikohet me Operatorët e Sistemit të Transmetimit; duke përfshirë marrëveshjet e pronësisë dhe marrëveshjet kontraktore për të vënë në punë dhe shërbim këtë pajisje;
2. Përshkrim dhe shpjegim i marrëveshjeve për rastet emergjente dhe planifikimit të riskut.
3. Shkresën e OST përkatëse ku konfirmohet pranimi i përshkrimit dhe shpjegimit të kërkuar më sipër dhe konfirmimi që kjo mënyrë, software dhe hardware janë të pajtueshme.

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.2:

do të jetë në gjendje të vendosë sistemet e nevojshme të komunikimit dhe praktikat për kordinim me Operatorët e Sistemit të Transmetimit

Interpretimi:

Aplikuesit duhet të vërtetojnë që ata janë në gjendje të vendosin komunikimin e nevojshëm dhe sistemet teknike e marrëveshjet për tu kordinuar me Operatorët e Sistemit të Transmetimit.

Dokumentacioni i nevojshëm si provë:

Sipas rastit, aplikuesi duhet të paraqesë dokumentat mbështetëse të mëposhtme:

1. Përshkrim dhe shpjegim të mënyrës si do të komunikohet me Operatorët e Sistemit të Transmetimit; duke përfshirë marrëveshjet e pronësisë dhe marrëveshjet kontraktore për të vënë në punë dhe shërbim këtë pajisje;
2. Përshkrim dhe shpjegim i marrëveshjeve për rastet emergjente dhe planifikimit të riskut.